

URDHËR I BRENDSHËM

Nr. 14, datë 9.1.2019

DELEGIM KOMPETENCE NË SU “SHEFQET NDROQI” TIRANË

Në mbështetje të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenit 29, ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, kreu VII, neni 56 “Titullari i autoritetit kontraktor”, të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

I. Delegimin e kompetencave të titullarit të SU “Shefqet Ndroqi” Tiranë, nëndrejtorit ekonomik, z. Skender Gjoni, për çështjet e mëposhtme:

1. Të nënshkruajë autorizimet për përfaqësim ligjor të SU “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë në të gjitha shkallët e gjykimit, duke përfshirë: kërkesëpadi, kërkesë, shtim, pakësim, saktësim apo heqje dorë nga objekti i kërkesëpadisë, kundërpadi, ankim dhe rekurs kundër vendimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare, kërkesë për pezullim, kërkesë për përjashtim gjyqtari, si dhe çdo kërkesë tjetër që ka lidhje apo del nga rrethanat e gjykimit të kësaj çështjeje, si dhe t’i nënshkruajnë ato. Përfaqësuesi i autorizuar nga nëndrejtori ekonomik, i përcaktuar sipas kësaj pike, ka të drejtë të kryejë çdo veprim procedural përpara gjykatës, konform parashi-kimeve të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, përveç rasteve kur kjo e drejtë kufizohet në aktin e autorizimit.

2. Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, për të gjitha procedurat e prokurimeve publike me fonde buxhetore dhe të ardhurat dytësore për SU “Shefqet Ndroqi”, Tiranë.

3. Autorizimet për dërgimin me shërbim të punonjësve të SU “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në largësi mbi 100 km dhe jashtë vendit.

4. Të nënshkruajë komunikimet e SU “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, me institucionet e administratës publike dhe palët e treta, me përjashtim të atyre komunikimeve dhe akteve që ligji ia atribuon shprehimisht titullarit të institucionit.

5. Të kryejë çdo veprimtari tjetër të ngarkuar me urdhër nga titullarit të institucionit.

II. Këto kompetenca do të ushtrohen nga nëndrejtori ekonomik menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

III. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit, si dhe pushimin e ekzistencës së organit delegues apo të deleguar.

IV. Ngarkohet z. Skënder Gjoni dhe të gjithë nëpunësit e SU “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI
Perlat Kapisyzi